



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

PROJEKT – RAPORT

PËR
AUDITIMIN ME BAZË SISTEMI
MBI

**“VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË, RREGULLSHMËRISË DHE
PERFORMANCËS SË REALIZUAR PREJ NDËRMARRJES SË
PASTRIMIT, GJELBËRIMIT DHE MIRËMBAJTJE VARREZA,
BASHKIA ROSKOVEC”.**

Periodha e audituar: 01.01.2019 deri 30.06.2020

Grupi i auditëve : Gilda Zyka

Eltona ÇEPELE

Gëzim HABILI

Roskovec, TETOR, 2020.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

PROJEKT RAPORT

***MBI ANGAZHIMIN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË NDËRMARRJEN E
PASTRIMIT, GJELBËRIMIT DHE MIRËMBAJTJE VARREZA, PRANË BASHKISË
ROSKOVEC.***

Mbahet sot më datë 05.10.2020 nga grupi i punës së audituesve të Sektorit të Auditimit të Brendshëm pranë Bashkisë Roskovec, mbi angazhimin e auditimit për ***“Vlerësimin e veprimitarisë në zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe performancës të realizuar nga Ndërmarrja e Pastrimit, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje Varreza, pranë Bashkisë Roskovec”***.

Angazhimi i auditimit në këtë subjekt u mbështet në Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” të miratuar me Urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave, si dhe programin e auditimit të miratuar nga Kryetare e Bashkisë.

I. Përmbledhje ekzekutive.

Sipas programit të auditimit të miratuar nga Kryetare e Bashkisë me shkresën nr. 4406, prot. datë 03.09.2020, ***“Mision angazhim auditimi për vlerësimin e veprimitarisë së Ndërmarrjes së Pastrimit, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje Varreza”***, grupi i auditimit i përbërë nga Përgjegjës grupi zj. Gilda Zyka., auditues zj. Eltona Çepele dhe z. Gëzim Habili, realizoi misionin e angazhimit të auditimit në Ndërmarrjen e Pastrimit, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje Varreza, pranë Bashkisë Roskovec.



Qëllimi i këtij mision auditimi është që të ndihmojë Ndërmarrjen e Pastrimit, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje Varreza, pranë Bashkisë Roskovec, në realizimin e objektivave të veprimtarisë duke përmirësuar sistemet e kontrollit të brendshëm, nxjerrja e konkluzioneve dhe dhënia e sigurisë objektive mbi dokumentimin e aktivitetit të të gjithë Sektorëve të saj, si dhe dhënia e rekomandimeve për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm për përmirësimin e punës në vazhdimësi, etj.

II. Hyrje

Gjatë kryerjes së misionit të auditimit, nga grupi i auditimit është synuar një vlerësim në tërësi i sistemeve në përputhje me Udhëzimet dhe metodikat e miratuara, me qëllim që sistemet e menaxhimit financiar e të kontrollit si dhe performanca e njësisë së audituar, të jenë transparente dhe në përputhje me normat e ligjshmërisë, rregullshmërisë, dobisë, frytshmërisë dhe kursimit.

Auditimi është realizuar nga data 04.09.2020 deri 30.09.2020, gjithsej 18 (tetëmbëdhjetë) ditë pune, për periudhën e audituar nga **01.01.2019 deri 30.06.2020**.

Janë diskutuar në Takimin fillestar (të Hapjes) me Drejtor të komanduar të Ndërmarrjes së Pastrimit, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje Varreza, si dhe P/Sektorit të Financës zj. Miranda Çepele, ish P/Sektorit të Financës z. Ermir Hajdini, si dhe me punonjës të tjerë të kësaj Ndërmarrjeje, objektivat, formatet, metodat e auditimit, linjat e komunikimit, si dhe afatet për raportime.

Gjatë këtij misioni auditimi janë realizuar të gjitha pikat e programit sipas tematikës së miratuar. Pasi ka përfunduar edhe puna në terren, janë diskutuar gjetjet (konstatimet) e këtij misioni auditimi me stafin e Ndërmarrjes së Pastrimit, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje Varreza të Bashkisë Roskovec, dhe është rënë dakort për çështjet e dala.

III. Metoda e Auditimit.

Gjatë realizimit të misionit të auditimit, grupi i punës i auditimit ka punuar në përputhje me udhëzimet dhe metodikat e miratuara. Është mbuluar me auditim periudha **01.01.2019 deri 30.06.2020**. Audituesit janë njohur me të gjithë dokumentacionin e kërkuar dhe kanë bërë një vlerësim në tërësi të sistemeve. Komunikimi i qartë, konçiz dhe në kohë me stafin e njësisë së audituar ka ndihmuar në eficientë dhe efektivitetin e procesit të auditimit.

Auditimi u krye në zbatim të kërkesave që përcakton Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe të Urdhëri nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”



IV. Gjetjet dhe konkluzionet.

Në zbatim të programit të miratuar u audituan çështjet si më poshtë :

I. Auditimi i sistemeve të Proçeseve Organizative.

- Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore ;

a. Zbatimi i Strukturës Organizative, si dhe zbatimi i nivelit të pagave.

Ndërmarrja e Pastrimit, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtjes së Varrezave, që është në varësi të Bashkisë Roskovec, e ushtron aktivitetin e tij në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” me ndryshimet përkatëse, si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Sektorin Publik” me ndryshimet përkatëse, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në R.SH.” i ndryshuar, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH.” i ndryshuar, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” me ndryshimet përkatëse, si dhe të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin e pasqyrat financiare” dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 4292, datë 15.06.2006 “Për shpalljen e standarteve kontabël kombëtare dhe zbatimi i detyrueshëm i tyre”.

Nga auditimi u konstatua se është hartuar **Rregullore e Brendshme** e Ndërmarrjes së Pastrimit, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtjes së Varrezave, në të cilën është shprehur Baza Ligjore ku mbështetet puna e kësaj Ndërmarrjeje, struktura organizative dhe funksionimi i saj. Për sa i përket kryerjes së detyrave, çdo nëpunës dhe punonjës i Ndërmarrjes ka të përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë, për të cilat përgjigjet para niveleve më të larta.

Për periudhën e audituar nga 01.01.2019 – 30.06.2020 rezultoi se, për Ndërmarrjen e Pastrimit, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtjes së Varrezave pranë Bashkisë Roskovec, ishin marrë Vendimet e Kryetares së Bashkisë për strukturën organizative dhe nivelin e pagave si më poshtë :

-Për vitin 2019 ishte marrë Vendimi i Kryetares së Bashkisë nr. 473, datë 26.12.2018, “Për miratimin e strukturës organizative dhe pagat përkatëse për Bashkinë Roskovec dhe Njësitë Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum dhe Ndërmarrjeve vartëse për vitin 2019”, ku për Ndërmarrjen e Pastrimit, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtjes së Varrezave ka miratuar 79 (shtatëdhjetë e nëntë) punonjës nga të cilët 1 (një) Drejtor, 1 (një) Përgjegjës i Sektorit të Financës, 1 (një) specialist, llogaritar arkëtar, 1 (një) specialist Burimet Njerëzore dhe 1 (një) Magazinier, për Sektorin e Pastrimit



41 (dyzetë e një) punonjës nga të cilët 1 (një) Përgjegjës i Sektorit të Pastrimit, 1 (një) Kryepunëtore, 7 (shtatë) punëtor të pastrimit të pikave të mbeturinave në Bashkinë Roskovec, 13 (trembëdhjetë) punëtor pastrimi në Bashkinë Roskovec, 2 (dy) Shofera të mjeteve të pastrimit të qytetit, për Njësinë Administrative Kuman 7 (shtatë) punonjës, nga të cilët 2 (dy) punëtorë pastrimi të pikave të mbeturinave në Njësinë Administrative Kuman, 3 (tre) punëtor pastrimi, 1 (një) roje, 1 (një) Shofer i mjetit për pastrim, për Njësinë Administrative Kurjan 4 (katër) punonjës, nga të cilët 2 (dy) punëtorë pastrimi të pikave të mbeturinave, 1 (një) punëtor pastrimi, 1 (një) Shofer i mjetit për pastrim, për Njësinë Administrative Strum 6 (gjashtë) punonjës, nga të cilët 3 (tre) punëtorë pastrimi të pikave të mbeturinave, 2 (dy) punëtor pastrimi, 1 (një) Shofer i mjetit për pastrim, për Sektorin e Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje Varrezave 33 (tridhjetë e tre) punonjës, nga të cilët 1 (një) Përgjegjës i Sektorit të Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje Varrezave, për Bashkinë Roskovec 12 (dymbëdhjetë) punonjës, nga të cilët 1 (një) Kryepunëtor gjelbërimi dhe mirëmbajtje varreza + shofer, 8 (tetë) punëtorë Gjelbërimi, 2 (dy) punëtorë mirëmbajtje varreza, 1 (një) roje e varrezave të qytetit, për Njësinë Administrative Kuman 9 (nëntë) punonjës, nga të cilët 5 (pesë) punëtorë Gjelbërimi, 4 (katër) punëtorë mirëmbajtje varreza, për Njësinë Administrative Kurjan 4 (katër) punonjës, nga të cilët 4 (katër) punëtorë mirëmbajtje varreza, Njësinë Administrative Strum 7 (shtatë) punonjës, nga të cilët 2 (dy) punëtorë gjelbërimi, 5 (pesë) punëtorë mirëmbajtje varreza.

Nga verifikimi i nivelit të pagave të përcaktuar në vendimet e mësipërme dhe të paguara (ekzekutuara) nga Sektori i Financës, nuk rezultuan shkelje të dispozitave ligjore të sipërcilësuar.

Nga auditimi i dokumentacionit për strukturën organizative të Ndërmarrjes së Pastrimit, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje Varreza pranë Bashkisë Roskovec, rezulton se është operuar me struktura të miratuara nga Kryetare e Bashkisë me Vendimet përkatëse për çdo vit të audituar. Për punonjësit e këtij Institucioni (Ndërmarrje) janë hapur dosjet e personelit si dhe janë lidhur kontratat individuale sipas Ligjit nr. 7961, datë 17.01.1995 “Kodi i Punës në RSH” i ndryshuar, të cilat administrohen nga Specialisti i Financës dhe Burimeve Njerëzore.

Për sa më sipër, rezulton se aktualisht asnjë punonjës nuk e gëzon statusin e nëpunësit civil, por operohet me kontratë pune, në mbështetje të Ligjit nr. 7961, datë 17.01.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” me ndryshimet përkatëse. Po këtu, evidentohet se, për periudhën objekt auditimi është operuar me strukturë të paplotësuar.



b. Zbatimi i kriterëve për dhënien e shpërblimeve mbi page, kontributet për sigurimet shoqërore, aplikimi i tatimit mbi të ardhurat, i tatimit në burim, e tj.

Gjatë ushtrimit të misionit të auditimit mbi zbatimin e kriterëve për dhënien e shpërblimeve mbi page, për periudhën e audituar *nuk rezultuan shkelje të dispozitave ligjore*, pasi për këtë periudhë nuk është planifikuar dhënia e shpërblimeve mbi page.

Nga verifikimi i transaksioneve të kryera për kontributet e sigurimeve shoqërore, tatimet dhe ndalesat e tjera, rezultoi se ato ishin përlllogaritur me saktësi.

II. Auditimi i sistemit të programimit dhe zbatimit të buxhetit.

Në hartimin dhe realizimin e buxheteve të viteve 2019 dhe 2020, janë zbatuar kërkesat dhe procedurat e përcaktuara në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” me ndryshimet përkatëse, në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin nr. 6/3, datë 10.07.2018 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, si dhe Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisve të vetëqeverisjes vendore”.

Parimet kryesore të funksionimit të sistemit buxhetor janë :

a-Transparenca, parashikueshmëria, uniteti dhe universaliteti në menaxhimin e sistemit buxhetor të të ardhurave ;

b-Shpërndarja e burimeve, në përputhje me objektivat strategjike të Ndërmarrjes së Shërbimeve të Mirëmbajtjes ;

c- Përdorimi me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet i të ardhurave.

Në hartimin e këtyre buxheteve janë pasqyruar të gjitha të ardhurat e shpenzimet, pavarësisht nga natyra e tyre dhe burimet e financimit . Ato janë paraqitur të balancuara mbi bazën e realizimeve të viteve të fundit, rritjes së të ardhurave, si dhe nevojave që kanë sektorë të veçantë të Ndërmarrjes për investime, apo shërbime të ndryshme.

Kështu, për planifikimin dhe programimin e buxhetit të vitit 2019, do të kemi :

A. Financimi i buxhetit të vitit 2019 paraqitet :



-Transfertë e Pakushtëzuar e Përgjithshme	13.500.000 lekë
-Transfertë e Pakushtëzuar Sektoriale	0
-Të ardhura viti 2019	32.403.751 “
SHUMA :	45.903.751 lekë

B. Shpenzimet për vitin 2019 paraqiten :

Në lekë

Nr.	EMËRTIMI	Llogaria	Viti 2019			Totali
			T.P.K Përgjithshme	T.P.K Sektoriale	Të Ardhura	
I	Menaxhimi i mbetjeve urbane					
1	Paga	600	6.000.000	0	13.374.960	19.374.960
2	Sig.Shoqerore	601	1.000.000	0	2.235.618	3.235.618
3	Shp.Operative	602	2.000.000	0	4.630.070	6.630.07
4	Investime	231	-	-	900.000	900.000
II	Menaxhimi i Gjelbërimit, Mirëmb. Varreza					
1	Paga	600	3.500.000	0	8.388.996	11.888.996
2	Sig.Shoqerore	601	6.000.000	0	1.385.462	1.985.462
3	Shp.Operative	602	4.000.000	0	450.640	850.640
4	Investime	231	-	-	1.038.000	1.038.000
	SHUMA		13.500.000	0	32.403.751	45.903.751

Miratimi i planifikuar i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2019 është bërë me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 104, datë 19.12.2018, i cili është konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier me shkresën nr. 2112, datë 28.12.2018. Ky plan paraqitet i balancuar midis të ardhurave dhe shpenzimeve dhe detajimi i tij është bërë mbi bazën e dispozitave ligjore të sipërcituara.



Të dhënat mbi zbatimin e buxhetit (shpenzimeve) në mënyrë analitike dhe zë për zë, jepen në pasqyrën si më poshtë :

Realizimi i tij sipas situacionit të muajit Dhjetor 2019 paraqitet :

Në 000/ lekë

Nr.	Llogaria	Transf. Pakushtëzuar		Të Ardhura		Totali		
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	%
1	600	9.500	9.478,5	21.763,96	20.766,5	31.263,96	30.245	96.7
2	601	1.600	1.598,17	3.621,08	3.486,92	5.221,08	5.085,09	97.3
3	602	2.400	1.216,6	3.980,71	1.334,44	6.380,71	2.551,04	39.9
4	231	-	-	1.938	1.746	1.938	1.746	90.1
	SHUMA	13.500	12.293,27	31.303,75	35.904,6	44.803,75	39.627,13	88.4

Në total, plani i buxhetit për vitin 2019 me gjithë ndryshimet që ka pësuar gjatë kësaj periudhe, është në shumën 44.803,75 mijë lekë dhe realizuar në shumën 39.627,13 mijë lekë, ose në masën 88.4 %. Konstatohet se ky buxhet është përdorur sipas të gjithë zërave të planifikuar dhe me ndryshimet që ka pësuar gjatë vitit.

Ndërsa, për planifikimin dhe programimin e buxhetit e vitit 2020, do të kemi :

A. Financimi i buxhetit të vitit 2020 paraqitet :

-Transfertë e Pakushtëzuar e Përgjithshme	16.639.198 lekë
-Transfertë e Pakushtëzuar Sektoriale	0 “
- Të ardhura Viti 2020	34.733.053 ”

SHUMA : 51.372.250 lekë

B. Shpenzimet për vitin 2020 paraqiten :

Në lekë

Nr	EMËRTIMI	Llogaria	Viti 2020			Totali
			T.P.K Përgjithshme	T.P.K Sektoriale	Të Ardhura	
I	Menaxhimi i					



	mbetjeve urbane					
1	Paga	600	7.714.868	14.327.612	14.327.612	22.042.480
2	Sig.Shoqerore	601	1.288.383	2.315.891	2.315.891	3.604.274
3	Shp.Operative	602	2.000.000	5.563.720	5.563.720	7.563.720
4	Investime	231	-	680.000	680.000	680.000
II	Menaxhimi i Gjelbërimit, Mirëmb. Varreza					
1	Paga	600	4.658.052	8.650.668	8.650.668	13.308.720
2	Sig.Shoqerore	601	777.895	1.389.552	1.389.552	2.167.446
3	Shp.Operative	602	200.000	638.790	638.790	838.790
4	Investime	231	-	1.166.820	1.166.820	1.166.820
	SHUMA		16.639.198	34.733.053	34.733.053	51.372.250

Miratimi i planifikuar i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2020 është bërë me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 116, datë 20.12.2019, i cili është konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier me shkresën nr. 1968/1, datë 30.12.2019. Ky plan paraqitet i balancuar midis të ardhurave dhe shpenzimeve dhe detajimi i tij është bërë mbi bazën e dispozitave ligjore të sipërcituara.

Të dhënat mbi zbatimin e buxhetit (shpenzimeve) në mënyrë analitike dhe zë për zë, për periudhën Janar – Qershor 2020 jepen në pasqyrën si më poshtë :

Në 000/lekë

Nr.	Llogaria	Transf. Pakushtëzuar		Të Ardhura		Totali		
		P (Vjetor)	Fakt	P (Vjetor)	Fakt	P (Vjetor)	Fakt	%
1	600	12.372,9	10.733,2	22.978,3	5.430,2	35.351,2	16.163,3	45,7
2	601	2.066,3	1.781	3.705,4	894,2	5.771,7	2.675,2	46,4
3	602	2.838,8	580,9	5.563,7	0	8.402,5	580,9	6,9
4	231	-	-	1.846,8	0	1.846,8	0	0
	SHUMA	17.277,9	13.095,1	34.094,3	6.324,4	51.372,3	19.419,5	37,8



Në total, plani i buxhetit për vitin 2020 (Janar – Qershor) me gjithë ndryshimet që ka pësuar gjatë kësaj periudhe, është në shumën 51.372,3 mijë lekë dhe realizuar në shumën 19.419,5 mijë lekë, ose në masën 37,8 %. Konstatohet se ky buxhet është përdorur sipas të gjithë zërave të planifikuar dhe me ndryshimet që ka pësuar gjatë vitit.

Duke krahasuar pasqyrat e financimit të buxheteve për gjithë periudhën e audituar (1 Janar 2019 – 30 Qershor 2020), konstatohet se fondet e vëna në dispozicion për përdorim në këtë njësi shpenzuese kanë qënë në rritje. Kjo ka ardhur si rezultat se, ndërsa për fondet buxhetore të akorduara për këtë njësi të qeverisjes vendore është ruajtur deri diku, i njëjti nivel (me pak ulje për vitin 2020), kryesisht për fondet nga të ardhurat vendore konstatohet rritje (përkundrejt vitit paraardhës) si në planifikim, dhe sidomos në realizim të tyre.

Nga auditimi i buxhetit, planifikimit (programimit) dhe realizimit të tij, vlerësojmë :

- Është respektuar disiplina buxhetore.
- Është respektuar autoriteti në disponimin e tyre.
- Është respektuar destinacioni i fondeve buxhetore.
- Janë kryer rakordimet mujore dhe vjetore me institucionet përkatëse për shpenzimet.
- Gjatë periudhës ushtrimore aktiviteti i subjektit ka qënë i mbuluar me buxhet.

3. Auditimi i sistemit të pagesave, duke mos sjellë dëm ekonomik.

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, u krye auditimi i të gjitha pagesave nëpërmjet bankës për periudhën e programuar, ku rezultoi se Urdhër Shpenzimet e përpiluara për çdo rast, kishin fletë porosi zyrtare të plotësuar saktësisht dhe faturën mbështetëse që i kishin dërguar njësisë shpenzuese. Nga verifikimi u konstatua se :

- Të gjitha pagesat e bëra ishin të sakta për çdo shërbim apo mall të blerë.
- Shpenzimet e kryera për shërbime e riparime, shoqëroheshin për çdo rast me preventiva dhe situacione, kurse mallrat e blera ishin bërë hyrje në magazinë sipas rregullave të përcaktuara në dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Për të gjitha rastet ishin përpiluar Faturat Tatimore të shitjes.
- Të gjithë Urdhër Shpenzimet për likudimin e shumave të përcaktuara në Fatura, kishin autorizim nga personi i autorizuar për të bërë një gjë tillë.



-Për të gjithë pagesat e kryera nga Ndërmarrja e Pastrim, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje Varreza pranë Bashkisë Roskovec, Urdhër shpazimet përkatëse kishin të bashkangjitura Faturat e vulosura nga Dega e Thesarit Fier.

-Nuk kishte raste të dublimit të pagesave.

-Për pagesat e bëra, para kryerjes së likuidimit të tyre, nga punonjësit e Sektorit të Financës bëhej shqyrtimi i tyre për të saktësuar shumat e dërguara. Për këtë bëhej rakordim sistematik ndërmjet pagesave të bëra për blerjen e mallrave dhe shërbimeve dhe sistemit të llogarive kryesore të Ndërmarrjes së Pastrim, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje Varreza (Bashkia Roskovec). Fusha e llogarisë që mbulonte pagesat për mallra e shërbime përdorte ruajtjen e tyre në më shumë se dy pasqyra të ndryshme. Të gjitha rastet e pagesave të bëra nga Njësia Shpenzuese (Ndërmarrja e Pastrim, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje Varreza, Bashkia Roskovec) për shpenzime të ndryshme e të likuiduara me Urdhër shpenzimi, ishin të vendosura në kodin e duhur të llogarisë.

-Dokumentat e bankës ishin plotësuar me të gjitha të dhënat e kërkuara sipas formatit “Tip”, nuk pati korrigjime; kishin të bashkangjitura dokumentat justifikues, kishin përshkrimin e veprimit, ishin të nënshkruara nga Titullari, Përgjegjësi i Sektorit të Financës, si dhe nga specialisti i Thesarit.

-Regjistrimet kontabile në ditarin e Thesar - bankës janë të pasqyruara rregullisht për çdo muaj e vit të audituar, duke pasqyruar me saktësi llogaritë korresponduese të shpenzimeve sipas strukturave buxhetore.

Nga krahasimi i tepricave të llogarisë “Thesar” të datës 31.12.2019, me pasqyrimet në aktivin e bilancit të vitit 2019, nuk rezultuan diferenca. Gjithashtu, u krahasuan tepricat e llogarisë “Banka” të pasqyruar në Rregjistrin kontabel me atë të konfirmave bankare të vitit 2019, për të cilat nuk rezultuan diferenca.

Rregjistrimet kontabile të llogarisë “Thesar” në ditarin e bankës me shumat korresponduese të llogarive përkatëse, rezultuan se ishin të pasqyruara në përputhje me Ligjin nr. 9228, date 29.04.2004 “Për kontabilitetin” me ndryshimet përkatëse. Këto pasqyronin me saktësi shpenzimet sipas Urdhër – Shpenzimeve të konfirmuara nga Dega e Thesarit Fier, konform kjo, sipas Manualit “Për klasifikimin buxhetor ekonomik”.

Për shpenzimet për udhëtim e dieta, në zbatim të përcaktimeve të VKM nr. 591, datë 23.07.2010 “Për disiplinimin e përdormit të fondeve buxhetore”, të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, si



dhe të VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë”, dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013 “Mbi zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë””, rezulton se, gjatë këtij misioni auditimi, për pagesat e kryera për shpenzimet për udhëtim e dieta (brenda dhe jashtë vendit), për të gjithë periudhën e audituar 1 Janar 2019 - 30 Qershor 2020 nuk u konstatuan të meta e parregullsi në zbatimin rigoroz të kërkesave të dispozitave nënligjore të sipërcilësuara, pasi nuk rezultojnë të jenë kryer pagesa për këto shpenzime.

Shpenzimet për transport.

Për auditimin e këtyre shpenzimeve për të gjithë periudhën Janar 2019 – Qershor 2020, u përqëndruam në kqyrjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm si ; Urdhër Shpenzimet (për blerjen e karburantit dhe kryerjen e shërbimeve për automjetet që ka në përdorim Ndërmarrja e Pastrim, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje Varrezave), si dhe Fletë-Hyrjet e Fletë-Daljet e magazinës, etj.

Në këtë mision angazhim auditimi konstatohet se, lëvizjet e automjeteve, evidentimit të tyre në Fletët e udhëtimit, evidentimit të volumeve të punimeve (orëve të punës), nënshkrimit të drejtuesve të automjeteve, nxjerrja e Urdhërave të Titullarit për ngritjen e Komisioneve të përlllogaritjeve të normativave të harxhimit të karburantit (respektivisht nr. 55, datë 30.01.2019 dhe nr. 2002, date 06.05.2020), të shoqëruara me proces verbalet përkatëse për çdo vit (date 04.02.2019 dhe 07.05.2020), e tj. Në inventarin e mjeteve të transportit që kjo njësi shpenzuese ka në përdorim, rezultojnë Kamion “Iveco Fiat” AA 478 JE, Kamion “Iveco Fiat” AA 183 FA, Kamion “Iveco Fiat” AA 630 VN, “Kama” AA 016 FT, “Kama” AA 816 OJ, Kamion “Renault” AA 425 UR.

Gjatë këtij auditimi (për të gjithë periudhën 01.01.2019 – 30.06.2020) nuk konstatohen të meta ose parregullsi në përlllogaritjen e karburantit të harxhuar (për lëvizje të mjeteve apo edhe të volumeve të punës (orëve të punës) të kryera nga disa mjete).

Për këtë periudhë rezulton se, shpenzimet për karburant e pjesë këmbimi, ndonëse zënë një peshë specifike të konsiderueshme të shpenzimeve operative, ato janë brenda limiteve të përcaktuara dhe të planifikuara me Vendime të Këshillit Bashkiak.

Shpenzimet për shërbime (ujë, energji, e tj.)

Nga auditimi i dokumentacionit të Thesar-bankës për kryerjen e pagesave për këto shpenzime, rezulton se ato janë bërë brenda limiteve të përcaktuara me Vendime të Këshillit Bashkiak (dhe të



konfirmuara në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier) dhe në bazë të dokumentave justifikues përkatës.

4. Auditimi i sistemit të prokurimeve, duke mos sjellë dëm ekonomik.

a. Prokurimet me vlera të vogla.

Në lidhje me procedurat e respektuara për këto prokurime, evidentohet se për mungesë personeli të kualifikuar e të specializuar, ndjekja e tyre realizohet nga Institucioni i Bashkisë Roskovec, për të cilat, me Urdhër të Titullarit të Bashkisë për çdo vit ushtrimor është ngritur Komisioni për prokurimet me vlera të vogla (nr. 3, datë 10.01.2019 dhe nr. 5, datë 12.01.2020). Nëpërmjet auditimit të veprimeve me bankë, u kqyr i gjithë dokumentacioni që ka të bëjë me këto prokurime, nga ku rezulton se është vepruar në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, Ligjit nr. 182/2014 datë 24.12.2014 “Për disa ndryshime e shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar me VKM nr. 893, datë 21.12.2016 “Për një shtesë në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik””, si dhe Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës të prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj në mënyrë elektronike”, e tj., në lidhje me respektimin e kufijve limit të përcaktuar për prokurimin e fondeve me procedurën e mësipërme. Për çdo shpenzim ekziston dokumentacioni i kërkuar si : Urdhër prokurimi, proces – verbalet e Komisionit të Llogaritjes së Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike (KLLFLST), proces – verbalet e Komisionit të vlerësimit të ofertave, preventivat (Për mirëmbajtje dhe riparime të ndryshme) dhe ai justifikues si, Fatura e shitësit, Fletë – hyrja në magazinë, situacionet, aktet (proces – verbalet) e marrjes në dorëzim, e tj.

b. Prokurime publike.

Nga auditimi i dokumentacionit të bankës për periudhën sipas programit Objekt auditimi (1 Janar 2019 deri 30.06.2020) rezultoi se, gjatë kësaj periudhë ishin prokuruar fonde publike për investime, shërbime dhe blerje, me procedurë të mirëfilltë tenderimi. Në këtë mision angazhim auditimi, u mjaftuam vetëm me kryerjen e realizimit të pagesave (përpilimit të Urdhër Shpenzimeve në shumat përkatëse mbështetur në dokumentacionin justifikues, si dhe në situacionet dhe Faturat Tatimore të subjekteve të ndryshme) për të gjitha objektet e prokuruar, procedurat e të cilave janë ndjekur dhe respektuar si më sipër cilësuar.



Auditim më të plotë për objektet e prokuruarra dhe të realizuara gjatë kësaj periudhe, do ta ndërmarrim në një periudhë të mëvonshme.

5. Auditimi i sistemit të të ardhurave.

a. Planifikimi i të ardhurave.

Nga auditimi i bërë në drejtim të planifikimit dhe realizimit të të ardhurave për të gjithë periudhën e audituar (1 Janar 2019 deri 30 Qershor 2020), si pjesë përbërëse e buxhetit të njësisë shpenzuese “Ndërmarrja e Pastrim, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje Varreza pranë Bashkisë Roskovec”, rezultoi se kjo njësi shpenzuese pavarësisht se realizon të ardhura (të cilat nuk i arkëton vetë si njësi), por i akordohen fonde nga të ardhurat që realizon “Njësia Shpenzuese mëme”, nga e cila, në përcaktimin e tarifave dhe taksave është mbajtur parasysh Paketa Fiskale e miratuar nga Qeveria për këto vite, si dhe Udhëzimet e nxjerra nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për këtë qëllim.

6. Auditimi i Sistemit të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar.

Gjatë kryerjes së këtij misioni anazhimi u audituan pasqyrat financiare të vitit 2019 dhe rezultoi: Me shkresë të veçantë nr. 161, datë 23.04.2020, janë dërguar (duke respektuar edhe afatet ligjore të dorëzimit) pranë Degës së Thesarit Fier “Pasqyrat Financiare të vitit 2019”, të cilat ishin pranuar e miratuar nga ky Institucion.

U audituan të gjitha pasqyrat financiare të vitit 2019 e konkretisht :

- Bilanci Kontabel ;
- Pasyra e të ardhurave dhe shpenzimeve ;
- Pasyra e burimeve dhe shpenzimeve për investimet ;
- Pasyra e lëvizjes në “Cash” ;
- Pasyra e Amortizimeve (Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme) ;
- Pasqyra e Lëvizjes së Fondeve ;
- Pasyra e numrit të punonjësve dhe Fondi i pagave ;
- Relacion spjegues për llogaritë vjetore.

* Nga auditimi i Bilancit të vitit 2019 të Ndërmarrjes së Pastrim, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje Varreza rezulton se, kishte përputhje të shumave të ditarit me ato të centralizatorit, si dhe ishin pasqyruar në mënyrë korrekte tepricat debitore e kreditore sipas rastit në aktiv dhe pasiv të Bilancit.



* Paraqitja e posteve në Aktiv të Bilancit ishte bërë në mënyrë korrekte dhe të gjitha zërat shoqëroheshin me inventarin kontabel, ku dhe gjendja e inventarit fizik përputhej me inventarin e paraqitur në aktiv të Bilancit.

* Nga verifikimii i Pasivit të Bilancit rezultoi se, ishin pasqyruar Fondet e veta, si dhe të gjitha detyrimet që ka Institucioni (Ndërmarrja e Pastrim, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje Varreza) ndaj të tretëve në fund të periudhës përkatëse (31.12.2019).

* U audituan “Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve” konkretisht Formati nr. 3/1 “Shpenzime të ushtrimit” dhe Formati nr. 3/2 “Të ardhura të ushtrimit”, nga ku rezultoi se ishin pasqyruar të gjitha shpenzimet e vitit ushtrimor sipas strukturës buxhetore dhe të ardhurat sipas burimeve e natyrës së tyre. Po kështu rezultoi, se të gjitha shpenzimet e vitit ushtrimor ishin të kuadruara me Degën e Thesarit Fier, bazuar kjo me situacionet e hartuara për çdo muaj e në mënyrë progresive, kurse të ardhurat kuadronin me aktin e rakordimit të të ardhurave, hartuar për çdo muaj e në mënyrë progresive.

* U audituan “Pasqyra e ndryshimeve në Fondet e Veta” , dhe rezultoi se për periudhën ushtrimore (viti 2017) ishin paraqitur të gjitha Lëvizjet e Fondeve, duke filluar nga teprica në fillim në çelje të ushtrimit, plus arkëtimet e vitit si nga fondet buxhetore , dhe të ardhurat e veta, si dhe në kredi ishin pasqyruar pagesat e vitit dhe transfertat. Në këtë pasqyrë ishin të evidentuar më vehte aktiviteti financiar, aktiviteti investues dhe ai i funksionimit.

* U audituan anekset e pasqyrave financiare si dhe materialet e tjera shpjeguese dhe rezultoi se ato ishin plotësuar sipas formatit të përcaktuar dhe me të gjitha të dhënat. Konkretisht ishin hartuar pasqyra e “Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet e vitit” (Formati nr.4), pasqyra e “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme” (Formati nr. 6), pasqyra e “Amortizimeve) (Formati nr. 7), pasqyra e “Numrit të punonjësve dhe Fondit të pagave” (formati nr. 9) dhe “Relacioni shpjegues për llogaritë vjetore”.

-Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet ishin trajtuar sipas Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit dhe Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, ndryshuar me Ligjin nr. 10110, datë 16.07.2006 “Për një ndryshim dhe një shtesë në Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare””, të shkresës nr. 4292, datë 15.06.2006 të Ministrit të Financave “Për shpalljen e Standarteve Kontabël Kombëtare dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, si dhe Vendimit nr. 3, datë 07.05.2006 të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.



7. Auditimi i Sistemit të kontrollit të brendshëm.

a- Vlerësimi i ambientit të kontrollit të brendshëm.

Ndërmarrja e Pastrim, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje Varreza (që është në varësi të Bashkisë Roskovec) ka një **Rregullore të Brendëshme** për mirëfunksionimin e administratës për ta ushtruar aktivitetin e saj në bazë dhe në funksion të dispozitave ligjore si, të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për taksat vendore” me ndryshimet përkatëse.

Marrja e Vendimeve bëhet nga Këshilli Bashkiak, ndërsa konfirmimi i tyre bëhet nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier.

Nisur sa më sipër, mjedisi i kontrollit të brendshëm është i saktësuar në këtë Rregullore.

b- Vlerësimi i aktivitetit të kontrollit operacional.

Nga vlerësimi i kontrollit operacional rezultoi se në përgjithësi analizohet periodikisht çdo muaj e çdo vit realizimi i detyrave funksionale të të gjithë punonjësve.

Në këtë kuadër ka programim të detyrave për çdo muaj, programim që është miratuar nga Titullari, por ndjekja e realizimit të tyre duhej të bëhej rregullisht. Në drejtim të realizimit të misionit kryesor të Ndërmarrjes së Pastrim, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje Varreza pranë Bashkisë Roskovec, nuk është bërë plotësisht i mundur realizimi i objektivave që ajo ka caktuar.

c- Vlerësimi i riskut.

Risku si nocion njihet përgjithësisht nga Aparati Drejtues dhe Administrativ i Ndërmarrjes së Pastrim, Gjelbërim dhe Mirëmbajtje Varreza pranë Bashkisë Roskovec, dhe mbi këtë bazë nga auditimi i kryer rezultoi se janë përcaktuar dhe vendosur limite për shpenzime të ndryshme në funksion të realizimit të aktivitetit të saj.

d- Vlerësimi i praktikave të monitorimit.

Vetë kontrolli (monitorimi) i Aparatit Drejtues, por dhe i personelit punonjës ka funksionuar pjesërisht, duke funksionuar si i tillë vetëm me praktikatat e inventarizimeve, por monitorimi i kontrolleve të brendëshme në përgjithësi ka munguar, kjo si rrjedhojë e mungesës së një sistemi të kontrollit të brendshëm vetëkontrollues e vetëkorrigjues.

e- Auditimi i performancës.

Ndërmarrja e Pastrim, Gjelbërim dhe Mirëmbajtje Varreza pranë Bashkisë Roskovec funksionon në bazë të dispozitave ligjore si, të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen



Vendore”. Mbështetur në misionin e saj, janë përcaktur objektivat dhe detyrat për çdo muaj dhe vit. Analiza e realizimit të këtyre detyrave pothuajse në të gjitha rastet është bërë për çdo muaj, si dhe kanë dalë përgjegjësitë nga strukturat drejtuese për çdo Sektor, zyrë e nëpunës.

8. Sisteme të tjera, duke mos sjellë dëm ekonomik.

a- Organizimi dhe funksionimi i llogarive të sektorit material.

Inventarizimi i pasurisë (aseteve) për vitin 2019, është bërë me komision të posaçëm të ngritur me Urdhër të Titullarit të Ndërmarrjes së Pastrim, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje Varreza, pranë Bashkisë Roskovec (përkatësisht nr.176, datë 03.12.2019), në zbatim kjo të Ligjit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin e KM nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe VKM nr. 170, datë 03.04.1993 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave material e monetare”. Inventarizimi ka përfunduar brenda afateve të duhura. Sektori i Financës pranë Ndërmarrjes së Pastrim, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje Varreza (pranë Bashkisë Roskovec) për vitin 2019 ka paraqitur relacionin përkatës (datë 26.12.2019) për nxjerrjen e asetëve (mallrave dhe materialeve) jashtë përdorimit, si dhe Komisioni i asgjësimit (ngritur me Urdhërin e titullarit të Ndërmarrjes së Pastrim, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje Varreza pranë Bashkisë Roskovec nr. 141, datë 24.03.2020) ka bërë ekzekutimin (asgjësimin) e tyre.

Nga verifikimi mbi **funksionimin e llogarive të sektorit material** për të gjithë periudhën 1 Janar 2019 – 30 Qershor 2020, për mbajtjen e kontabilitetit në drejtim të rregjistrimit të fletë-hyrjeve dhe fletë-daljeve në mënyrë kronologjike për mallrat dhe materialet e ndryshme të magazinuara, për mbajtjen e evidences kontabile mbi lëvizjen e çdo artikulli (hyrje – daljet e tij), për nxjerrjen e gjendjes për secilin prej tyre në fundt të çdo periudhe, nuk u **konstatuan shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik.**

Konkluzion : *Për periudhën sipas programit objekt auditimi nuk rezultoi dëm ekonomik.*

Por, gjatë këtij misioni auditimi u evidentuan edhe të meta e parregullsi, të cilat konsistojnë në :

1. Për Sektorin e Pastrimit :

- Dokumentacioni i shërbimit të pastrimit për periudhën e audituar nuk ishte i plotë, si dhe finalizimi i tij paraqitej (për çdo muaj) nëpërmjet Situacionit të mangët (të pa vlerësuar), ku në të pasqyrohen të gjitha zërat e punës të kryer, si dhe volumet e tyre, të pa shoqëruara me analizën e



5. Për një mirëadministrim dhe menaxhim sa më efektiv të shpenzimeve sidomos për shërbimet e Pastrimit dhe Gjelbërimit, të hartohen Preventivat dhe Situacionet mujore, në zbatim të Buletineve (Manualeve) të analizave të çmimeve, të miratuara nga Ministrinë e linjave përkatëse.

Për sa më sipër hartohet ky Projekt – Raport Auditimi në 3 (tre) kopje, nga të cilat 1 (një) kopje i lihet Ndërmarrjes së Pastrim, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje Varreza pranë Bashkisë Roskovec, dhe mbas nënshkrimit si më poshtë, 1 (një) kopje i dorëzohet grupit të auditimit.

**P/NDËRMARRJEN E PASTRIM, GJELBËRIMIT
DHE MIRËMBAJTJE VARREZA.**

DREJTOR (I komanduar)

Miranda ÇEPELE




P/SEKTORIT TË FINANCËS

Miranda ÇEPELE



Ish P/SEKTORIT TË FINANCËS

Ermir HAJDINI



Grupi i auditimit

Gilda ZYKA



Eltona ÇEPELE



Gëzim HABIL

